

MINISTRI I EKONOMISË  
NR. 675  
DATE 21-10-2004



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 675 , datë 14.10.2004

P Ë R

MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES SË  
KONCESIONIT PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR "NËNË  
TEREZA", NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TIRANA AIRPORT  
PARTNERS (TAP), SHPK, SI DHE TË PROJEKTMARRËVESHJES  
MBËSHTETËSE TË ORTAKËVE, NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE HOCTIEF  
AIRPORT GmbH, FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR  
NDËRMARRJET DHE TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP),  
SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe të ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të projekt marrëveshjes së koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Airport Partners (TAP), shpk, si dhe të projekt marrëveshjes mbështetëse të ortakëve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Hochtief Airport GmbH, Fondit Shqiptaro-Amerikan për Ndërmarrjet dhe Tirana Airport Partners (TAP), shpk.

2. Autorizohet Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) për nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit dhe të marrëveshjes mbështetëse të ortakëve.
3. Autorizohet Ministria e Financave të negociojë me BERZh-in dhe Tirana Airport Partners (TAP), shpk, për kredinë prej 9 000 000 (nëntë milionë) Euro-sh, që Tirana Airport Partners (TAP), shpk, do të marrë nga BERZh-i për financimin e infrastrukturës publike.
4. Anëtarët e grupit negociator dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, të përcaktuar në pasqyrën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të shpërblehen, nga fondi i krijuar për këtë qëllim, si më poshtë vijon:
  - Grupi negociator me 7 (shtatë) paga mujore të drejtorit të aeroportit;
  - Komisioni i vlerësimit të ofertave me 4 (katër) paga mujore të drejtorit të aeroportit.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**FATOS NANO**


MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE I TELEKOMUNIKACIONIT

SPARTAK POÇI



MINISTRI I EKONOMISË

ANASTAS ANGIJELI



**Pasqyra nr.1****Grupi negociator**

1. Merita Xhafa (Kryetare dhe drejtore e Përgjithshme e Aviacionit)
2. Ilir Zeqo (Drejtor i kabinetit të ministrit të Ekonomisë)
3. Semihal Loca (Ministria e Ekonomisë)
4. Altin Vrapit (Drejtorja e Përgjithshme e Aviacionit)
5. Ylli Spahaj (Drejtorja e Përgjithshme e Aviacionit)

**Komisioni i vlerësimit të ofertave**

1. Dhimitraq Rafti (Kryetar dhe zëvendësministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit)
2. Aleksandër Hoxha (Drejtor i ALB Transportit, sha)
3. Jeton Parapani (ALB Transport, sha)
4. Yllka Zaloshnja (Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit)
5. Etleva Kondi (Ministria e Ekonomisë)
6. Feim Godo (Drejtorja e Përgjithshme e Aviacionit)
7. Luan Jaupaj (Drejtorja e Përgjithshme e Aviacionit)

NR.PROT.2967  
DATË 20.10.2004

PRESIDENCËS  
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË  
TELEKOMUNIKACIONIT  
MINISTRISË SË EKONOMISË  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË MBROJTJES  
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

KSENOFON KRISAFI  
Në mungesë dhe me porosi

ŠOKOL ESHAZI

